



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:091583

Datë: 09.09.2022

Numri i dokumentit: 03407907

PPP.nr. 20/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përbarimore me Gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Drejtori S.M, kundër debitorit S.D nga fsh. S. K.Istog, për shkak të borxhit në shume prej 1,620.00 €, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit, me dt: 15.04.2022 kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit, gjykata jashtë seance me dt.09.09.2022 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit S.D nga fsh. S. K.Istog, ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit P.nr.284/2022 të dt. 04.04.2022, sipas propozimit të kreditorit Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në P..

A r s y e t i m

Kreditori, Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në P., ka ushtruar propozimin për përbarim tek përbaruesi privat në bazë të dokumentit përbarimor, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përbarimi ndaj debitorit S.D nga fsh. S. K.Istog, si në shkresat e lëndës, me kërkesë që të obligohet debitori pagesa e shumes së borxhit prej 1,620.00 € si dhe 30 € në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të gjitha brenda afatit 7 ditor nga pranimi i urdhrin, në të kundërtën të bllokohen llogaritë bankare dhe të konfiskohen të gjitha mjetet financiare deri në shumën e borxhit prej 1,620.00€ si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të gjitha këto të specifikuar në propozimin e dt. 04.05.2022.

Përbaruesi privat me urdhrin e përbarimit P.nr.284/2022 të dt. 04.04.2022, e ka lejuar propozimin për përbarim në këtë çështje përbarimore.

Debitori, S.D nga fsh. S. K.Istog, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim, me arsyetimin se është bërë vlerësim i gabuar i gjendjes faktike, konsideroj se jam i dëmtuar dhe kërkesa e kreditorit është shumë e lartë në krahasim me mundësitë e mia dhe demin e shkaktuar dhe i propozoi gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit S.D nga fsh. S. K.Istog dhe të anulohet Urdhri Përbarimor i Përbaruesit Privat, P.nr.284/22 i datës 04.04.2022.

Kreditori, është njoftuar me prapësimin e debitorit, dhe nuk ka dhënë përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog, si përmbartimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësim nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, sipas të cilave do të pengohej përmbartimi i lejuar nga përmbartuesi privat.

Gjykata, pas shikimit të shkresave të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në faktin se është bërë vlerësim i gabuar i gjendjes faktike, të njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si të pabazuara pasi që kreditori propozimin për përmbartim e ka paraqitur në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës C.nr.290/19 i cili me datë 30.11.20 është bërë i i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 15.12.2020 dhe i njëjti vendim i plotëson të gjitha kushtet ligjore konform nenit 21, 22 1.1, 36 dhe 38 të LPP-së.

Se debitori i obligohet kreditorit shumë si në propozim për përmbartim, këtë fakt gjykata e mbështet në nenin 245 të LMD-së ku par.1 i po të njëjtit nën parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po të njëjtit nën parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërbllimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Gjykata, pretendimet e debitorit në prapësim i refuzoj si të pabazuara për faktin se të njëjtat ishin në kundërshtim me provat e prezantuara në vet shkresat e lëndës, dhe nuk ishin të bazuara në nenin 69 dhe 71 të LPP-së.

Gjykata konform nenit 17 të LPP-së, përshtatshëmrisht aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Prandaj nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 3, 21, 22 par 1.1, 36, 38, 69 71, 73 par 3 të LPP-së (Ligjit për Procedure Përmbartimore) dhe në lidhje me nenin 245 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.20/2022, dt. 09.09.2022

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.